



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:070398

Datë: 03.06.2019

Numri i dokumentit: 00342575

PKR. nr. 17/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti për Krime të Rënda, në përbërjen e trupit gjykues Nikollë Komani, kryetar, Mentor Bajraktari dhe Besnik Beslimaj, anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarve B.I. nga Gjakova, E.M. nga . dhe I.A. nga . Republika e Shqipërisë, tani me banim në Gjakovë, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarve B. I. dhe I. A. edhe për veprën penale kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 87/2018 të datës 26.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësor me datë 26.04.2019, 07.05.2019 dhe 30.05.2019, në prezencën e prokurorit Ali Uka, të akuzuarit B. I. dhe mbrojtëses së tij B.K. avokate në Gjakovë, të akuzuarit E. M. dhe mbrojtësit të tij I. H. avokat në Gjakovë, të akuzuarit I.A. dhe mbrojtësit të tij Q. J. avokat në Gjakovë, me datë 31.05.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **03.06.2019** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **B. I.**, i biri i Xh.dhe N., e gjinisë H., data e lindjes... në Gjakovë, ku edhe jeton në rr.” A. K.” nr. ... i martuar, atë i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, elektrikist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 15.12.2018.

I akuzuari **E.M.** i biri i F. dhe M., e gjinisë S., data e lindjes... në ., ku edhe banon në rr.”P. B.” lagja Sh., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i divorcuar, atë i një fëmije, kuzhinier, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 15.12.2018.

I akuzuari **I. A.**, i biri i Y. dhe B. e gjinisë Z., i lindur data e lindjes... në fshatin ., Republika e Shqipërisë, tani me banim në Gjakovë rr. “F.A.”, i divorcuar, atë i një fëmije, nuk din shkrim-lexim, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Shqipërisë, gjendet në paraburgim nga data 15.12.2018.

Të akuzuarit B. Ib.dhe I. A.

JANË FAJTOR

Sepse me datë 14.12.2018 pa autorizim e importojnë substancën psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128 dhe atë marihuanë, në atë mënyrë që me automjetin Rent a Car- . . .(....) të cilin e ka siguruar i pandehuri E. pasi takohen në Gjakovë, kanë shkuar në vendin e quajtur Sukë tek fshati ... tek shtëpia e të pandehurit I.A. aty marrin një qese najlon ngjyrë të bardhë në të cilin kanë vendosur narkotikun e llojit marihuan me qëllim të trafikimi në Republikën e Kosovës dhe me automjetin kanë ardhur në pikën kufitare Qafë Prush, i pandehuri E. dhe dëshmitari S. M. me automjet kalojnë pikën kufitare ndërsa dy të pandehurit B.dhe I.në mënyrë ilegale kanë kaluar kufirin shtetërorë të cilët me datën 15.12.2019 në ora 05:00 janë arrestuar nga ana e policisë Kosovës, ndërsa nga ekzaminimi laboratorik i forenzikës me numër AKF/.. të pranuar nga prokuroria me datë 18.03.2019, është konstatuar se dëshmitë #1 dhe 1.1 kishin në posedim 457,27 gram substancë narkotike të llojit marihuan.

- **me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

I akuzuari B.I..

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.12.2018 në ora 04:30/h në territorin e Republikës së Kosovës në vijën kufitare me Republikën e Shqipërisë pikërisht në Qafë Prush, i pandehuri duke anashkaluar vendkalimin të autorizuar kufitare të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në mënyrë ilegale përmes rrugëve malore të quajtur Qafa malit në afërsi të pikës kufitare Qafë Prush ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, ku rrugës në brendësi të territorit të Kosovës pasi është hasur nga policia i njëjti është arrestuar.

- **me çka ka kryer veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së.**

I akuzuari I.A.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.12.2018 në ora 04:30/h në territorin e Republikës së Kosovës në vijën kufitare me Republikën e Shqipërisë pikërisht në Qafë Prush, i pandehuri duke anashkaluar vendkalimin të autorizuar kufitare të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë në mënyrë ilegale përmes rrugëve malore të quajtur Qafa malit në afërsi të pikës kufitare Qafë Prush ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës, ku rrugës në brendësi të territorit të Kosovës pasi është hasur nga policia i njëjti është arrestuar.

- **me çka ka kryer veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 par. 1 nën par. 1.4, 80, 83, 273 par. 1, 146 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarve I dhe I.Allçi, ua përcakton veç e veç dënimit dhe atë:

- për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të përshkruar në pikën e I-rë, të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 5 (pesë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1000,00 € (njëmijë euro);
- për veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar në pikën e II-të, të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj;

Bazuar në nenin 80 dhe 83 të KPRK-së, i :

G J Y K O N

Të akuzuarin B.I. dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.12.2018, si dhe **Dënim** me gjobë në shumën prej 1000,00 € (njëmijë euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 50 ditëve, duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Të akuzuarin I.A. dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.12.2018, si dhe **Dënim** me gjobë në shumën prej 1000,00 € (njëmijë euro), të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti dënim do ti zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 30 ditëve, duke ja llogaritur 20,00 € për një ditë burgimi.

Detyrohen të akuzuarit që se cili veç e veç ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100,00 €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajnë po ashtu veç e veç shpenzimet në shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 457,27 gram si objekt i kryerjes së veprës penale.

Për të akuzuarin E. M.

Bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së

REFUZOHET AKUZA

Se me datë 14.12.2018 rreth orës 18:00 pa autorizim e importojnë substancën psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr. 02/L-128 dhe atë marihuanë, në atë mënyrë që me automjetin Rent a Car- . . (...) të cilin e ka siguruar i pandehuri E. pasi takohen në Gjakovë, kanë kërkuar në vendin e quajtur Sukë tek fshati .. tek shtëpia e të pandehurit I.A. aty marrin një qese najlon ngjyrë të bardhë në të cilin kanë vendosur narkotikun e llojit marihuan me qëllim që trafikimi në Republikën e Kosovës dhe me automjetin kanë ardhur në pikën kufitare Qafë Prush, të pandehurit S.dhe E. me automjet kalojnë pikën kufitare ndërsa dy të pandehurit B dhe I. në mënyrë ilegale kanë kaluar kufirin shtetërorë të cilët me datën 15.12.2019 në ora 05:00 janë arrestuar nga ana e policisë Kosovës, ndërsa nga ekzaminimi laboratorik i forenzikës me numër . . .të pranuar nga PTH me datë 18.03.2019, është konstatuar se dëshmitë #1 dhe 1.1 kishin në posedim 457,27 gram substancë narkotike të llojit marihuan.

- **me çka në bashkëkryerje do të kishte kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Për shkak të tërheqjes së prokurorit nga ndjekja penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë me aktakuzën PP/I-nr. 87/2018 të datës 26.03.2019, ka akuzuar I. E. M. dhe I. A. , për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe të akuzuarit B. I. dhe I. A. edhe për veprën penale kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare nga neni 146 par. 1 te KPRK-së.

Prokurori Ali Uka në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale ndaj të akuzuarve B. I. dhe I.A. të akuzuar për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në tërësi u provua se në veprimet e këtyre dy të akuzuarve qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga aktakuza. Ka theksuar se të akuzuarit B.I. dhe I. A. si në polici, prokurori, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë pranuar veprën penale nga aktakuza, si dhe veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-

së, e ky pranimi i fajësisë nga ana e tyre ka mbështetje edhe në provat e siguruar gjatë hetimeve dhe të propozuara në aktakuzë, e të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ka shtuar se faktin se këta dy të akuzuarit i kanë kryer këto vepra penale e provojnë edhe raporti i ekspertizës i përpiluar nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë në Prishtinë me datë 27.02.2019, nga i cili rezulton se substanca narkotike e cila është sekuestruar nga këta dy të akuzuar është e llojit kanabis, përkatësisht marihuan në peshë prej 457,25 gram, e po ashtu edhe nga raporti i oficerit policor, si dhe foto-albumi i vendit të ngjarjes dhe substancës narkotike të sekuestruar, andaj

mbështetur në këto prova ka deklaruar se mbetet pranë aktakuzës dhe kualifikimeve juridike sa i përket të akuzuarve B. I. i dhe I. A. , si dhe bazuar në nenin 273 par. 3 të KPRK-së, ka kërkuar që ndaj të njëjtëve të shqiptohet dënim plotësues konfiskimi i substancës narkotike e llojit marihuan në peshë prej 457,27 gram. Ka shtuar se sa i përket të akuzuarit E. M. gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor duke u mbështetur edhe në deklaratimet e të akuzuarve I.dhe I.A. të cilët kanë theksuar se i akuzuari Eg. M.nuk ka ditur për këtë veprë penale, e pastaj edhe nga dëshmia e dëshmitarit S.M. dhe provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk është arritur që të provohet fajësia e të akuzuarit E.M., andaj ka hequr dorë nga aktakuza dhe ndjekja penale për të akuzuarin E. për veprën penale të përshkuar në dispozitivin e I-rë. Ka shtuar se i propozon gjykatës se bazuar në faktin se telefonat që janë konfiskuar nga i akuzuari B.I. dhe atë telefoni i markës Iphone 4 me ngjyrë të bardhe dhe Iphone ... me ngjyrë të zezë, si dhe një telefon i konfiskuar nga E.M. i llojit Samsung . . .të ju kthehen të njëjtëve pasi nuk është arritur të provohet se të njëjtit janë objekt i veprës penale.

Mbrojtësja e të akuzuarit B.I., avokatja B.K.në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se në këtë gjykatë është zhvilluar procedura penale ndaj të akuzuarit B.I. i akuzuar për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe për veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së, për të cilat vepra në tërësi e ka pranuar fajësinë pa asnjë presion, lajthim apo shtrëngim, pasi që të njëjtit nga ana e mbrojtësve i janë shpjeguar të gjitha pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë, bazuar në nenin 248 të KPP-së. Ka shtuar se edhe pse gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.04.2019, pas propozimit të prokurorisë ka marrë vendim për refuzimin e pranimin të fajësisë ndaj të mbrojturit të saj e lut gjykatën që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ta vlerësoi pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese pasi që i mbrojturi i saj që nga fillimi e deri në përfundim të procedurës e ka pranuar fajësinë. Si rrethanë tjetër lehtësuese të merret parasysh bashkëpunimi i të akuzuarit me organet e drejtësisë, qëndrimi i tij korrekt ndaj gjykatës, gjendjen e varfër ekonomike, faktin se është prind i një fëmije të mitur dhe mbajtës si vetëm i familjes, pendimin e sinqertë për veprën e kryer dhe vullnetin e tij për tu shëruar nga varësia nga substancat narkotike, e ku familjarët e tij edhe për kundër kushteve shumë të dobëta ekonomike i kanë caktuar një termin për bllokada nga droga në një klinikë private në Kotorr, si dhe premtimi i të akuzuarit se në të ardhmen nuk do të përsërisë apo të kryen ndonjë veprë tjetër të kësaj natyre apo të ngjashme. Ka theksuar se bazuar në të lartcekurat konsiderojnë se edhe me shqiptimin e një dënimi sa më të butë, do të arrihet risocializimi i tij, preventiva gjeneralë dhe e përgjithshme, shprehja e gjykimit shoqërorë për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

I akuzuari B.I. si gjatë shqyrtimit fillestar, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë për dy veprat penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar se është konsumues i mjeteve narkotike që 12 vite, është mjekuar në repartin psikiatrik në Gjakovë, por ka pasur

edhe në spitalin në Kotorr të Malit të Zi për tu trajtuar për bllokadë kundër drogës, ku i është caktuar tri herë termini. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka deklaruar se nuk ka pasur të holla kur ka shkuar në Shqipëri, nuk ka blerë drogë, por drogën e kanë pasur për konsumim personal, si dhe në Shqipëri kanë shkuar thjeshtë për një drekë apo darkë, pasi të akuzuarin E.M. e njeh nga burgju, e përmes telefonave duke biseduar kanë vendosur të shkojnë në Shqipëri. Ka shtuar se i akuzuari E. nuk ka qenë në dijeni për substancën narkotike, ndërsa

të akuzuarin I. e njeh 2-3 vite para rastit, jeton në Gjakovë, është përdorues i substancën narkotike, nuk ka dëgjuar se merret me shit-blerjen e substancave narkotike, në Shqipëri kanë shkuar me automjet golf 5 të cilin i akuzuari E.e ka marrë me renta e ku të akuzuarin E.e ka ftuar vet ndërsa me të tjetër janë takuar rastësisht. Kanë kaluar nëpër pikën kufitare Qafe Morinë, automjetin e ka drejtuar i akuzuari E., kanë shkuar në Fushë Krujë kanë ngrënë darkë sa mban mend ka paguar S. M., ku kanë qëndruar afërsisht një orë, e pastaj kanë shkuar në Durrës, ku i akuzuari I. është ndalur që ta takoj vëllain e tij, e pastaj vëllai i tij i ka ftuar që të hynë brenda për të ngenë bukë, por nuk i kujtohet se a kanë hyrë brenda E. dhe S. qëndruar afërsisht gjysmë ore, ku I. i mori disa lekë nga vëllai i tij, e kur janë nisur për në Kosovë në Fushë Krujë ju ka shpërthyer goma e automjetit, e kur me Izmirin kanë shkuar për të urinuar e kanë gjetur një qese me marihuanë dhe pasi janë konsumues e kanë marrë e vetë personalisht e ka fshehur përfundi jaknes. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka deklaruar se kur kanë arritur në pikën kufitare në Qafë Prush me I. kanë zbritur nga makina, E. dhe S. kanë kaluar me automjet nëpër pikën kufitare, e kur kanë zbritur nga makina E. i ka thënë se kanë për tu takuar me një shokë me qëllim që i njëjti mos ta kuptoi për drogën që e kanë pasur, pasi nuk i kanë treguar kur e kanë gjetur, e kur e kanë kaluar kufirin në këmbë kanë takuar E. me automjet, e kanë ndalur, kanë hipur dhe menjëherë i kanë ndalur policia e vetë pasi e ka pasur qesen me drogë në dorë e ka gjuajtur e ora ka qenë 04:00-04:30. Ndërsa duke u përgjigjur në pyetjen se në deklaratën e juaj të dhënë në prokurori me datë 08.01.2019 kur jeni pyetur se ku e keni marrë drogën, keni theksuar se nuk e din se ku e ka marrë I., është përgjigjur se e vërteta është se e kanë gjetur drogën për të cilën nuk i kanë treguar E., të cilin e njeh nga burgu pas vetë ka qenë 5 (pesë) vite në burg për vepra të ndryshme, ndërsa për E. nuk ka për dijeni për cilat vepra ka qenë në burg. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se kërkon falje për veprën e ndodhur, narkotikun të cilin e kanë gjetur e kanë pasur për përdorim personal dhe garanton se më nuk do të ndodhë kryerja e ndonjë veprë tjetër penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. A., avokati Q. J. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë procedurës së provave është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tij në një mënyrë të caktuar është involvuar në kryerjen e veprës penale nga neni 273 par. 1 lidhur me 31 të KPRK-së, pasi i mbrojturi i tij që nga veprimet e para parapenale nuk e ka mohuar faktin se për këtë veprë penale mban një shkallë të përgjegjësisë, sepse sasinë e mjeteve narkotike të gjetur gjatë rrugëtimit nga Shqipëria për në Kosovë e ka pasur për përdorim personal, me që gjatë asaj periudhe kohore ka qenë përdorues i mjeteve narkotike, andaj përgjegjësinë për këtë veprë penale e trajton duke u bazuar në faktin se ai nuk i ka lajmëruar organet kompetente me kohë se në automjetin ku udhëtonte gjendej edhe sasia e narkotikëve të lartë cituar. Po ashtu ai ka pranuar se ka kryer veprën penale nga neni 146 par. 1 të KPRK-së ashtu që me datën e shënuar në aktakuzë ka kaluar jashtë pikës së rregullt kufitare nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas pa poseduar dokument identifikimi, andaj për këto arsye i propozon trupit gjykues që me rastin e shqiptimit të sanksionit penale për veprat penale të lartë cituara, të ketë parasysh faktin se i mbrojturi i tij së bashku me të akuzuarin e parë e kanë pasur në posedim sasinë e narkotikëve për përdorim personal, por për veprimet tjera të shënuar sipas dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me blerjen, shpërndarjen e këtyre substancave janë të mendimit se nuk ka shkallë të përgjegjësisë, andaj në këtë drejtim të mos fajësohen për veprën penale në fjalë. Ndërsa për veprën penale të kalimit pa dokument identifikimi propozon që gjykata të ketë parasysh që është hera e parë që ai vepron në këtë mënyrë dhe me rastin e shqiptimit të sanksionit penal për veprat penale të lartë cituara të merren parasysh se i mbrojturi i tij është i moshës relativisht të re, është hera e parë që bie ndesh me ligji, atë i një fëmije, i cili ka mbetur në kujdesin e nënës së tij të moshuar, jeton në kushte jashtëzakonisht të vështira materiale arsye kjo që ja ka imponuar që të lënë vendlindjen dhe të vije në Kosovë për të punuar si punëtor krahu, andaj në këtë aspekt dhe për këto shkaqe ka theksuar se edhe me sanksion më të butë

penal do të arrihet efekti juridik për risocializimin e tij në shoqëri, ashtu që i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit ti shqiptoi në sanksion në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë për veprat penale të lartë cituara.

I akuzuari I.A. si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për dy veprat penale. Gjatë mbrojtjes së tij ka theksuar se që 11 vite jeton në Gjakovë, është i divorcuar, ka një vajzë e cila jeton me të, të akuzuarin B. e njeh para 2-3 viteve, ndërsa të akuzuarin E.dhe dëshmitarin S. M. nuk i njeh, është përdorues i narkotikëve, e arsyeja që kanë vendosur për të shkuar në Shqipëri ka qenë vetëm dëshira për të shkuar në Krujë, e ku kanë vendosur së bashku me të akuzuarin B., kanë qenë duke biseduar në një kafiteri në Gjakovë e pas 2-3 orëve ju janë bashkuar edhe i akuzuari E. dhe dëshmitari S. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka deklaruar se kur kanë kaluar pikën kufitare nga Kosova për në Shqipëri e ka pasur letërnjoftimin, fillimisht kanë shkuar në Krujë e më pas kanë shkuar në Durrës, me qëllim që ta takoi vëllain për të ja marr disa para. Ka shtuar se drogën e kanë gjetur së bashku me B. por nuk i kujtohet se a e kanë gjetur në hyrje të Fushë Krujës apo në dalje, mirëpo drogën e ka mbajtur B., e kur janë kthyer në Kosovë pasi e kishte harruar letërnjoftimin së bashku me B. kanë kaluar nëpër mal e jo nga pika kufitare në Qafë Prush, ndërsa E.dhe S. kanë kaluar me automjet nëpër pikën kufitare, e janë takuar sërish rastësisht me të njëjtit, e ku menjëherë i ka ndalur policia e gjatë kontrollit e kanë gjetur drogën në tokë. Ka shtuar se i akuzuari B. e ka pasur pasaportën me veti por i njëjti rrugës së malit për ta kaluar kufirin ka shkuar vetëm për ta shoqëruar atë pasi e kishte harruar letërnjoftimin, si dhe B. është përdorues i substancave narkotike dhe të shtëpia e tij në Durrës përpos vëllait e ka takuar edhe nënën. Ka theksuar se nga Kosova për në Shqipëri kanë kaluar nëpër pikën kufitare Qafë Morinë të Tropojës, e ka pasur letërnjoftimin me veti e kur kanë shkuar te shtëpia e tij në Durrës brenda kanë hyrë edhe B. dhe E., pasi S. ka qenë në gjumë në automjet, kanë ngrënë bukë dhe ora ka qenë 24:00h/, kur janë nisur nga shtëpia për në Kosovë, e pas 30 minutave pasi janë nisur ju është shpërthyer goma e automjetit të cilin e ka drejtuar E. , kur kanë shkuar për të urinuar i akuzuari B. e ka gjetur në qese me drogë, i ka treguar vetëm atij, nuk ju ka treguar E. dhe S.dhe drogën B. e ka fshehur

nën duks-jakne. Duke u përgjigjur serish në pyetjen se pse kur janë kthyer në Kosovë nuk kanë kaluar nëpër pikën kufitare është përgjigjur vetëm pse nuk e ka pasur letërnjoftimin, pasi kur ka shkuar te shtëpia e tij në Durrës, i ka ndërruar rrobat dhe e ka harruar letërnjoftimin në shtëpi, sepse po ta kishte letërnjoftimin do të kalonte nëpër pikën kufitare, si dhe për faktin se e ka harruar letërnjoftimin nuk i ka treguar E. por i ka treguar vetëm B.. Ka shtuar se kur kanë zbritur nga makina për të kaluar jashtë pikës kufitare drogën e ka marr me veti B.dhe E.i kanë thënë se arsyeja pse por zbresin nga makina është se kanë për ta takuar një shokë e atij i kanë thënë shkoni ju dhe me B. kanë bërë plan që në Gjakovë me shkuar në këmbë. Kur është ballafaquar me njoftimin se në pikën kufitare Qafë Morinë kur keni kaluar nga Kosova për në Shqipëri e keni përdorur dokumentin e vëllait A. A. ka theksuar se e ka përdorur gabimisht dokumentin e vëllait pasi e ka pasur me veti. Në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se kërkon falje dhe drogën e ka pasur për përdorim personal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e procedimit të provave, vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Se të akuzuarit B.I. dhe I. A. së bashku edhe me të pandehurin E. M. dhe dëshmitarin S.M. me datë 14.12.2018 pasi takohen në Gjakovë, kanë shkuar në Shqipëri duke kaluar nëpër pikën kufitare në Qafë Morinë në ora 13:37:21 dhe pa autorizim e importojnë substancën psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 nenin 14 të Ligjit për Barnat Narkotike, Substanca Psikotrope dhe Prekusore nr. 02/L-128 dhe atë marihuanë, në

atë mënyrë që me automjetin Rent a Car- . . (...) të cilin e ka siguruar i pandehuri E., kanë shkuar në vendin e quajtur Sukë, tek fshati ., te shtëpia e të akuzuarit I.A., aty marrin një qese najlon ngjyrë të bardhë në të cilin kanë vendosur narkotikun e llojit marihuan me qëllim të trafikimit në Republikën e Kosovës dhe me të njëjtin automjet kanë ardhur në pikën kufitare Qafë Prushë, e ku i pandehuri E. dhe dëshmitari S. me automjet kalojnë nëpër pikën pikën kufitare, ndërsa dy të akuzuarit B. dhe I në mënyrë ilegale kanë kaluar kufirin shtetërorë, e me veti e kishin edhe substancën narkotike, e ku pasi në mënyrë ilegale e kanë kaluar kufirin e kanë dalë në territorin e Kosovës, janë takuar serish dhe kanë hipur në automjet të cilët menjëherë në ora 05:00 të mëngjesit të datës 15.12.2018 janë arrestuar nga ana e policisë së Kosovës, ju është gjetur substanca narkotike e cila pas ekzaminimit është konstatuar se është llojit marihuanë në peshë prej 457,27 gram.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dëshmia e dëshmitarit S. M. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.04.2019, raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë . . . të datës 27.02.2019, raporti i oficerit policor i datës 15.12.2018, dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 15.12.2018, certifikata e lindjes për M. A., kontrata mbi dhënien e veturës me qira-renta dhe përgjigja me shkrim e dhënë nga firma "A." në Mitrovicë, foto-albumi, raportet e thirrjeve telefonike, njoftimi nga sistemi për menaxhimin e kufirit i datës 14.12.2018, si dhe nga vetë deklaratimet e të akuzuarve B.I. dhe I. A. të cilët e kanë pranuar fajësinë për veprat penale.

Dëshmitari S. M. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 26.04.2019, ka theksuar se të akuzuarin Be njeh, të akuzuarin E. nuk e njeh, ndërsa të akuzuarin I. e njeh si figurë në Gjakovë por nuk është shoqëruar me të. Ka shtuar se atë ditë kur janë nisur për në Shqipëri vetë i ka paguar 20,00 €, për karburant por i ka pasur 200,00 € me veti. Për në Shqipëri janë nisur rreth orës 13:00 h/, pasi e ka marrë terapinë në spital, vetë e ka konsumuar edhe një dozë me narkotikë në automjet si dhe e ka pirë tableta diazepam e pastaj e ka marr gjumi. Ka theksuar se në Shqipëri kanë kaluar që të katërtit nëpër pikën kufitare, kanë shkuar në Fushë Krujë, kanë ngrënë darkë të cilën e ka paguar vetë, e pastaj kanë shkuar në një vend që quhej Sukë, e nuk e dinë se a është shtëpia e të akuzuarit I.. Ka shtuar se edhe kur janë kthyer për në Kosovë ka fjetur, i kujtohet kur i akuzuari E. i ka thënë qohu dhe ja ka kërkuar letërnjoftimin se kanë arritur në pikën kufitare, por të akuzuarit B. dhe I. nuk kanë qenë në automjet, nuk ka për dijeni se kah kanë shkuar por sa i kujtohet i akuzuari E. i ka thënë se ata i kanë rënë nga mali, e pas 100 metra pasi e kanë kaluar kufirin janë takuar me të akuzuarit B.dhe I. , e nuk kanë kaluar as 20 metra kur janë ndaluar nga policia e jashtë automjetit e kanë gjetur substancën narkotike. Ka theksuar se nuk ka pasur për dijeni se kanë pasur substanca narkotike me veti dhe policia narkotiket i kanë gjetur jashtë automjetit në largësi prej 2-2.5 metra, në anën e djathtë të automjetit në të cilën pjesë ka qenë i ulur vetë dhe përpara tij i akuzuari B. . Kur i kanë ndaluar policia në automjet kanë qenë të katërtit, automjetin e ka vozitur i akuzuari E.dhe nga momenti i nisjes deri kur i kanë ndaluar policia nuk ka zbritur nga automjeti vetëm njëherë për të urinuar, kur kanë ngrënë darkë dhe kur i kanë ndaluar policia. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka deklaruar se për të shkuar në Shqipëri i ka thënë i akuzuari B.i cili nuk i ka treguar për arsyen e shkuarjes, vetëm ja ka kërkuar 20,00 € për benzinë për automjet, të akuzuarin B. e njeh qysh para 20 viteve, ka për dijeni se më herët ka konsumuar substanca narkotike pasi kanë konsumuar së bashku por tani nuk ka për dijeni se a është konsumues, me të akuzuarin B.kanë qenë së bashku në burg, vetë për vepra penale të vjedhjes, ndërsa për të akuzuarin B. nuk e dinë për cilat vepra penale ka qenë në burg.

Nga raporti i ekspertimit i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë . . . të datës 27.02.2019 është konstatuar se pas ekzaminimit substanca narkotike ka qenë e llojit kanabis (marihuanë) në peshë neto 457.27 gram.

Nga raporti i oficerit policor i datës 15.12.2018, është e konstatuar se me datë 15.12.2018, rreth orës 04:45h/, gjatë organizimit të një prite policore në lokacionin Qafë Prush është ndaluar vetura të cilën e ka drejtuar E.M. e në momentin e ndalimit në veturë kanë qenë edhe tre persona Be. I.i, I. A. dhe S. M.dhe në momentin e ndalimit të veturës njëri nga pasagjeret nga vetuar e ka hedhur një këse plastike nga dritarja, e ku është vërtetuar se nga vetuar është hedhur substanca narkotike e llojit marihuanë.

Nga dëftesa mbi konfiskimin e pronës e datës 15.12.2018, është konstatuar se janë konfiskuar një qese najloni me substanca narkotike të llojit marihuanë në peshë prej 539 gram, dy telefona Iphon .. dhe Iphon .. nga i akuzuari B.I. dhe një telefon Samsung nga i akuzuari E. M..

Nga certifikata e lindjes për M. A.e datës 23.10.2018 është e konstatuar se e njëjta ka lindur me datë 22.06.2018 në Gjakovë nga prindërit I.A. dhe J. L..

Nga kontrata mbi dhënien e veturës me qira nga Rent a Car “A.” në Mitrovicë dhe përgjigja me shkrim është e konstatuar se vetura e markës . . . për datat 13-14.12.2018, i është dhënë me qira të akuzuarit E.M., e ku është e konstatuar se kontrata vlen për Kosovë dhe jashtë saj.

Nga foto-albumi vërehet substanca narkotike e gjetur e ku shihet se gjatë matjes pesha e saj është 539 gram.

Nga raportet e thirrjeve telefonike është e konstatuar se të akuzuarit B. I.dhe E. M. kanë komunikuar mes veti pesë herë me datën 12.12.2018 dhe dy herë me datën 13.12.2018.

Nga shkresa-njoftimi nga sistemi për menaxhimin e kufirit i datës 14.12.2018 në ora 13:37:21 është e konstatuar se në pikën kufitare Kosovë-Shqipëri, gjegjësisht në Qafë Morinë kanë kaluar E. M., S.M., Be. I. dhe A.. A..

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë, ashtu edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pretendimet e mbrojtjes të parashtruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe të gjitha provat e administruara veç e veç, e pastaj të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe ka konstatuar se të akuzuarit B. I. dhe I.A., në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata përkundër faktit se të akuzuarit e kanë pranuar në tersi fajësinë për dy veprat penale, nuk e ka aprovuar pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari i tretë E. M., i akuzuar se në bashkëkryerje me të akuzuarit B.dhe I. e kanë kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nuk e ka pranuar fajësinë, pas administrimit të

provave, prokuroria në fjalën përfundimtare është tërhequr nga ndjeka penale për të akuzuarin E.M..

Gjykata edhe pse të akuzuarit e kanë pranuar në tërësi fajësinë për dy veprat penale si gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në prezencën e mbrojtësve të tyre, ka analizuar dhe vlerësuar pretendimet e të akuzuarve të parashtruara gjatë mbrojtjes së tyre dhe ka konstatuar se pretendimet e të akuzuarve kanë qenë vetëm përpjekje e tyre për ta minimizuar përgjegjësinë penale që e kanë për këto vepra penale dhe si të tilla nuk ju është falur besimi, pasi që deklaratimet e të akuzuarve kanë qenë kontradiktore me vetveten.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtën e tyre të akuzuarit kanë deklaruar se kur kanë qenë duke u kthyer për në Kosovë, kur ju është shpërthyer goma e automjetit në Fushë Krujë, e kanë gjetur substancën narkotike, mirëpo ky deklaram i të akuzuarve nuk përputhet me deklaratat e tyre të dhëna në prokurori në prezencën e mbrojtësve të tyre, ku i akuzuari B. në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 08.01.2019, ka theksuar se nuk e dinë se ku e ka marr drogën i akuzuari I., e po ashtu edhe i akuzuari I. në deklaratën e tij të dhen në prokurori me datë 08.01.2019 ka theksuar se i akuzuari B. qesen me drogë e ka marr në fillim kur kanë ngrënë bukë. Andaj, gjykata bazuar në faktin se deklaratimet e të akuzuarve kanë qenë kontradiktore, si dhe duke u bazuar edhe në të kaluarën e të akuzuarve, ku të akuzuarit B. dhe E. si dhe dëshmitarin S. kanë qenë të dënuar për vepra penale të natyrës së njëjtë, por edhe i akuzuari I. për vepra tjera penale, gjykata nuk ja ka falur besimin pretendimeve të akuzuarve se i kanë gjetur substancat narkotike, por si të tilla këto pretendime të akuzuarve i ka konsideruar vetëm përpjekje të tyre për ta zvogëluar përgjegjësinë penale që kanë për këto vepra penale.

Gjykata deklarimeve të akuzuarve nuk ja ka falur besimin edhe për faktin se i akuzuari I. ka theksuar se kur ka kaluar në pikën kufitare në Qafë Morinë, nga Kosova për në Shqipëri, e ka pasur letërnjoftimin me veti, por kur ka shkuar te shtëpia e tij në Durrës, pasi i ka ndërruar rrobat e ka harruar letërnjoftimin e vet, e mungesa e letërnjoftimit ka qenë arsyeja se kur janë kthyer në Kosovë ka kaluar rrugës së malit e jo nëpër pikën kufitare, mirëpo se edhe ky deklaram i të akuzuarit ka qenë i pabazuar gjykata e ka argumentuar nga shkresa-njoftimi nga pika kufitare në Qafë Morinë ku është e konstatuar se i akuzuari I. edhe kur e ka kaluar kufirin nga Kosova në Shqipëri në Qafë Morinë e ka përdorur letërnjoftimin e A.A. , për të cilin i akuzuari thekson se e ka vëlla dhe kur i akuzuari I. është ballafaquar me këtë fakt gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi e ka dhënë mbrojtjen e tij, ka theksuar se e ka përdorur gabimisht letërnjoftimin e vëllait. Andaj gjykata saktësisht e ka argumentuar se arsyeja pse të akuzuarit B. dhe I. kanë kaluar në këmbë jashtë pikës kufitare kur kanë hyrë në Kosovë ka qenë substanca narkotike që e kanë pasur me veti, e jo mungesa e letërnjoftimit ashtu siç pretendon i akuzuari I., sepse po mos e kishin substancën narkotike do të kalonin nëpër pikën kufitare, e ku i akuzuari do ta prezantonte letërnjoftimin në emër të A. A. ashtu siç ka vepruar kur ka kaluar në pikën kufitare në Qafë Morinë, pasi i njëjti e kishte me veti dokumentin e A. A. në momentin kur janë ndalur nga policia dhe janë arrestuar.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana rënduese për të akuzuarin B. I. ka marrë parasysh faktin se i njëjti ka qenë i dënuar për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe atë në lëndët penale P. nr. 593/05 vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 229 par. 1 KPK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muajve si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300,00 €,

si dhe ka qenë i dënuar për vepra penale të vjedhjes nga neni 253 i KPK-së, në lëndët penale P. nr. 564/07, P. nr. 574/07, ndërsa për të akuzuari I. A. pasi është shtetas i Shqipërisë sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga policia është e konstatuar se deri me datë 15.12.2018 nuk ka qenë në kërkim kombëtar apo ndërkombëtar, por i akuzuari ka qenë disa herë i proceduar për vepra penale të ndryshme si mbajtja pa leje e armëve të zjarrit, plagosje e lehtë me dashje, heqje e paligjshme e lirisë. Ndërsa si rrethana lehtësuese për dy të akuzuarit, ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga dy të akuzuarit, pendimin e tyre, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjendjen e varfër ekonomike, për të akuzuarin I. edhe faktin që ka një fëmijë të mitur e për të cilin përkujdeset nëna e tij, e të cilat rrethana kanë ndikuar që gjykata përkundër faktit që të akuzuarit kanë qenë edhe më parë të dënuar, për veprën penale të përshkruar në pikën e I-rë, të dispozitivit të këtij aktgjykimi ti zbatoj dispozitat e zbutjes së dënimit nga neni 76 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, dhe të ju shqipton dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor për këtë vepër penale, ashtu që të akuzuarit B. I. dhe I. A. veç e veç i ka gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do të ju llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.12.2018, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 1000,00 €, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e të akuzuarve dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Pasi që prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor në fjalën e tij përfundimtare është tërhequr nga ndjekja penale për të akuzuarin E. M., gjykata bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPP-së, ka marrë aktgjykimin me të cilën ka refuzuar akuzën për veprën penale për të cilën ka qenë i akuzuar të përshkruar si në pjesën refuzuese të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për konfiskimin e substancave narkotike të llojit marihuanë në sasi prej 457,27 gram është marrë bazuar në nenin 273 par. 5 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
PKR. nr. 17/19 datë 03.06.2019

Sekretarja juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh llogaritur nga dita e pranimin të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.